REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7647 Nr. i faq/Br.str/No.pg 67
Data/Datum/Date 14 07 /26
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

***Komuna e Rahovecit***

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

**Smajl Latifi**

# Raport për zbatimin e Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit

**Rahovec, korrik 2026**

## Përmbledhja


Hyrje ........ 3

Përmbledhje ekzekutive ........ 4

Objektivat e Planit të Integritetit ........ 4

Vlerësimi i progresit ........ 5

I. Nënfushat e përgjithshme të rrezikut ........ 6

II. Nënfushat e veçanta të rrezikut ........ 7

Sfidat dhe pengesat ........ 7

Rekomandime dhe hapat e ardhshëm ........ 7

Tabela për zbatimin e Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit ........ 8

# Hyrje

Komuna e Rahovecit, konform mandatit ligjor që ka dhe planit vjetor të punës për vitin 2026 ka paraparë që të harton edhe raportin për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës.

Plani i Integritetit është monitoruar nga koordinatori për monitorimin e zbatimit të tij dhe përfshinë të gjitha veprimet të cilat janë të pasqyruara në kuadër të këtij plani, si dhe informatat të cilat janë dhënë nga drejtorit, sektorët. Me qëllim të monitorimit të tij dhe analizës së zbatimit të masave/veprimeve, është hartuar raporti për periudhën janar - qershor 2026.

Raporti përfshinë periudhën janar - qershor, 2026 dhe përfshinë veprimet e ndërmarra në kuadër të fushave: **a)** fushave të përgjithshme të rrezikut dhe **b)** fushave të veçanta të rrezikut, të cilat janë vendosura në Planin për Integritet. Andaj, edhe raporti është realizuar përmes informatave plotësuese nga ana e drejtorive. Mbi bazën e këtyre informatave, është arritur që të analizohet dhe vlerësohet gjendja aktuale e zbatimit të masave/veprimeve nga plani i veprimit.

**Metodologjia e përdorur,** gjatë monitorimit të planit të veprimit për Integritet në Komunën e Rahovecit, ka pasur një cikël të metodave:
1. Fillimisht është dërguar një email njoftues tek njësitë e komunës lidhur me veprimet dhe obligimet e tyre së bashku me planin e veprimit;
2. Janë dërguar edhe email-at rikujtues, në mënyrë që të plotësohet raporti për Planin e Integritetit;
3. Pas marrjes së planit të veprimit, janë analizuar masat/veprimet e raportuara, si dhe në fund është hartuar raporti për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Rahovecit për periudhën janar – qershor, 2026. Raporti është raport narrativ dhe statistikor.

**Të gjeturat**. Në bazë të informatave mbi zbatimin e Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit, në periudhën janar – qershor 2026 janë planifikuar: 2 fusha të rrezikut (1 fushë e përgjithshme dhe 1 fushë e veçantë), 17 nënfusha të rrezikut dhe 97 masa/veprime të propozuara për zbatim, nga të cilët janë zbatuar 91 masa ose 93.80%, dhe 6 masa/veprime ose 6.20% nuk është zbatuar ose nuk janë ofruar informata adekuate, gjë që e kemi poentuar si të pazbatuara.

Sa i përket ndarjes së fushave, në kuadër të fushës së përgjithshme të rrezikut, janë 4 nënfusha të rrezikut dhe 32 masa të propozuara, ku edhe janë të zbatuar të gjitha. Sa i përket fushës së rrezikut të veçantë, janë gjithsej 13 nënfusha të rrezikut dhe 65 masa të propozuara, nga të cilat 59 janë zbatuar dhe 6 masa/veprime ende jo. Për të gjitha masat/veprimet dhe informatat e tjera, më poshtë i kemi dhënë sqarimet e hollësishme.

## Përmbledhje ekzekutive

Raporti i përfshin dy (2) fusha të rrezikut, fushën e veçantë dhe fushën e përgjithshme me gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) nënfusha, dhe gjithsej nëntëdhjetë e shtatë (97) masa të propozuara, nga të cilat nëntëdhjetë e një (91) janë realizuar, dhe gjashtë (6) janë në proces të realizimit.

Plani është monitoruar në vazhdimësi dhe si referencë kanë qenë dokumentet e miratuara, aktet e nxjerra të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me Planin e Integritetit apo në mënyrë të tërthortë.

Gjatë monitorimit, si sfidë ka qenë identifikimi i rreziqeve të reja të cilat mundë të ndikojnë në integritetin e institucionit dhe që do të ndikonte në mënyrë negative në imazhin apo besimin e institucionit, dhe për këtë është bërë përpjekje në identifikimin e rreziqeve të mundshme që mund të paraqiten në të ardhmen, mënyrën e ndërhyrjes për paraqitjen, përfshirjen në plan të këtyre rreziqeve dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për parandalimin e këtyre rreziqeve.

Në fazat e mëvonshme do të bëhet ndryshimi i këtyre masave në bazë të rreziqeve të mundshme që mund të paraqitën.

Plani për Integritet është i publikuar në faqen ueb të komunës https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/01/Plani-Komunal-per-Integritet-2024-2027.pdf

## Objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe rendit përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në Komunë.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një mekanizmi gjithëpërfshirës, ku të gjithë individët dhe njësitë në Komunë, si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.

- Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve mbi rreziqet e korrupsionit dhe të sensibilizojë qytetarët dhe bizneset për rolin e tyre në parandalimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

- Përmirësimi dhe forcimi i mekanizmave të raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në Komunë.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve komunale.
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

## Vlerësimi i progresit

Më poshtë mundë të njiheni më detajisht me mënyrën e realizimit, zbatimit të masave:

- Masa është zbatuar në kohën e duhur: **19;**
- Masa është zbatuar pas afatit;
- Masa është zbatuar në mënyrë periodike: **72;**

- Masa nuk është zbatuar për shkak të menaxhimit joadekuat të procesit;
- Masa nuk është zbatuar për shkak të menaxhimit joadekuat të institucionit;
- Masa nuk është zbatuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore;
- Masa nuk është zbatuar për shkak të mungesës së buxhetit;
- Masa nuk është zbatuar për arsye të tjera: **6;**
- Masa nuk është zbatuar për shkak se ende nuk është arritur afati për zbatimin e masës;

## I. Fusha e përgjithshme e rrezikut

Në kuadër të kësaj fushe, janë gjithsej 4 nënfusha të rrezikut, me gjithsej 32 masa të propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve, ku edhe janë të zbatuara të gjitha. Të gjitha këto të dhëna, i kemi pasqyruar si vijon:




**Diagrami 1**: *Progresi i arritur në fushën e përgjithshme në kuadër të zbatimit të Planit për Integritet në Komunën e Rahovecit (janar – qershor 2026).*

## II. Fusha e veçantë e rrezikut

Në kuadër të kësaj fushe janë gjithsej 13 nënfusha të rrezikut me gjithësej 65 masa të propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve nga të cilat 59 janë të realizuara dhe në proces janë edhe 6 masa, si vijon:




**Diagrami 2**: *Progresi i arritur fushën e veçantë në kuadër zbatimit të Planit për Integritet në Komunën e Rahovecit (janar – qershor, 2026).*

### Sfidat dhe pengesat

Gjatë monitorimit të Planit për Integritet, sfidë ka qenë identifikimi i rreziqeve të mundshme që mund të paraqiten dhe ndërmarrja e masave të reja në mënyrë të parandalimit të rrezikut të mundshëm.

### Rekomandime dhe hapat e ardhshëm

Në të ardhmen duhet të zgjerohet grupi punues për plotësim-ndryshimin e planit me nga një zyrtar prej secilës drejtori apo njësi, në mënyrë që të identifikohen rreziqet e mundshme dhe ndërmarrja e masave të nevojshme në mënyrë të parandalimit të rrezikut.

**Tabela për zbatimin e Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit**

| Të dhënat e Planit të Integritetit | | | | | | Raportimi i zbatimit | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizimit** | **Veprimet e ndërmarra** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** | **Rekomandimet** |
| 1 | **DREJTIMI DHE MENAXHIMI** | Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jotransparente, si dhe mospërfshirja e të gjitha fushave përkatëse për zhvillimin e komunës në Planin Zhvillimor. | Përditësimi i informatave në faqen ueb të Komunës, për t'i informuar qytetarët dhe mediat për aktivitetet e komunës. | Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit, drejtuesit e drejtorive komunale | Në vazhdimësi | Në baza ditore, bëhet përditësimi i informatave, aktiviteteve dhe lajmeve për ngjarjet që ndodhin në dhe për institucionin e komunës së Rahovecit. Transmetimi i mbledhjeve të Kuvendit bëhet online në faqen ueb zyrtare, kanalin youtube dhe facebook. | E realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?newscpt=miratohet-plani-zhvillimor-komunal-per-tete-vitet-e-ardhshme-2023-2031 | Gjatë fazës përgatitore ka pasur vështirësi në procesin e hartimit dhe të miratimit, si dhe marrjen e pëlqimit | Pas zbatimit të kësaj mase, kjo mund të largohet nga Plani për Integritet |
| 2. | | Opinion publik negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal për | Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve me procedurat për hartimin dhe miratimin e akteve me interes publik | Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit dhe drejtuesit e drejtorive komunale | Në vazhdimësi | Në të gjitha grupet punuese për hartimin e akteve, rregulloreve dhe planeve, një anëtar i përket shoqërisë civile. Po ashtu, bazuar në Udhëzimin Administrativ për standardet minimale të konsultimeve publike publikohen me kohë (14 ditë para) aktet dhe rregulloret, si dhe njoftimet | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shkak të transparencës së pamjaftueshme | me qëllim të përfshirjes së tyre në vendimmarrje | | | për konsultime publike, duke iu mundësuar secilit që të ketë mundësi të jap sugjerime dhe vërejtje dhe kështu të bëhet direkt pjesë e vendimmarrjes komunale. | | | | | |
| 3. | | Mospërputhja dhe paqartësia e përgjegjësive në administratën komunale | Rishikimi i organizimit të brendshëm të administratës përmes Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | Ligjet dhe aktet nënligjore; Raportet periodike; aktet e brendshme të komunës, Plani i Integritetit | 9 muaj | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve. analizojnë dhe rishikojnë detyrat e punës sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Është aprovuar rregullorja e brendshme për sistematizimin e vendeve të punës | E realizuar | | | | |
| 4. | | | Të monitorohet dhe raportohet rregullisht zbatimi i Planit të Integritetit | Mekanizmat përkatës të përcaktuar me vendim të Kryetarit të komunës | 3 muaj | Me vendim të kryetarit është caktuar Koordinatori për Integritet, i cili së bashku me drejtorët e drejtorive përkatëse, bën monitorimin e zbatimit të Planit për Integritet, si dhe raportimin në lidhje me zbatimin e tij. | E realizuar | | | | |
| 5. | | Mospërputhja dhe paqartësia e përgjegjësive | Të rishikohet niveli i zbatimit dhe | Menaxheri i integritetit | 6 muaj | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe | E realizuar | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në administratën komunale | të përditësohen masat për përmirësime. | , Koordinatori dhe Grupi Punues i integritetit | | udhëheqësit e sektorëve. analizojnë dhe rishikojnë detyrat e punës sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | | | | |
| 6. | **POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE** | Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të mjaftueshëm | Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit për zbatimin e | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, | 12 muaj | Plani i Personelit hartohet çdo vit gjatë muajit tetor të vitit paraprak, për vitin pasues. Plani i Personelit për vitin 2026 është hartuar nga udhëheqësi i Njësisë për Burime | E realizuar | | | Pas zbatimit, kjo masë duhet të largohet nga Plani për Integritet. |
| 7. | | Profesionalizmi dhe kompetenca e pamjaftueshme e të punësuarve. | Zbatimi i parimit të meritës gjatë procedurave të punësimit | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive | Në vazhdimësi | Gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit zbatohet parimi i meritës, duke u përzgjedhur kandidati që plotëson kushtet e përcaktuara dhe arrin rezultatet më të mira në procesin e vlerësimit. Testi me shkrim zhvillohet nga Ministria e Digjitalizimit dhe Administrates Publike, duke garantuar transparencë, paanshmëri dhe mungesën e çdo ndikimi nga autoritetet | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | komunale apo persona të tjerë. | | | | |
| 8. | | | Të bëhet analiza e nevojave për trajnime | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive eprorët | Në vazhd imësi | Është realizuar analiza e nevojave për trajnimin e zyrtarëve komunalë. Gjithashtu, Plani i Trajnimeve është përfshirë në Planin e Personelit, në përputhje me praktikën e viteve paraprake. | E realizua r | | | |
| 9. | | | Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarve | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive eprorët | Në vazhd imësi | Trajnimet organizohen nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike. Pas pranimit të ftesave për trajnim, Njësia për Burime Njerëzore i njofton me kohë zyrtarët komunalë të sektorëve përkatës, sipas tematikës së trajnimit. | E realizua r | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10. | | | Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive eprorët | Në vazhdimësi | Janë realizuar vlerësime lidhur me efektivitetin dhe ndikimin e trajnimeve të mbajtura, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të zhvillimit profesional të zyrtarëve. | E realizuar | | | |
| 11. | | Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të paqarta, joadekuate dhe të papërditësuara | Të bëhet rishikimi dhe standardizimi i detyrave të punës, si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës. | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve. | 9 muaj | Komuna e Rahovecit ndodhet në procesin e hartimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm. Në kuadër të këtij procesi po hartohen edhe përshkrimet e detyrave të punës për të gjithë zyrtarët komunalë. Për këtë qëllim, me vendim të Kryetarit të Komunës është formuar komisioni përkatës, i cili është duke punuar në përfundimin e këtij procesi. | E realizuar | | | |
| 12. | | | Të harmonizohen përshkrimet e vendeve të punës me proceset dhe procedurat përkatëse të punës. | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve | 9 muaj | Përshkrimet e detyrave të punës janë në proces harmonizimi nga komisioni i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës, në përputhje me proceset dhe procedurat përkatëse të punës. | E realizuar | | | Duhet të vazhdojë trajnimi i zyrtarëve. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13. | | | Të ju ridorëzohet përshkrimi i vendit të punës të gjithë nëpunësve | Njësia e Burimeve Njerëzore, të gjithë nëpunësit | Në vazhd imësi | Pas përfundimit të procesit të hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të detyrave të punës, secilit zyrtar komunal do t'i dorëzohet përshkrimi përkatës i vendit të punës, në afatin e paraparë. | E realizua r | | | |
| 14. | | Delegimi i kodit komunal të etikës për të gjithë zyrtarët komunalë përfshirë zyrtarët publikë, të zgjedhurit dhe të emëruarit. | Raportimi i zbatimit të Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunalë përfshirë zyrtarët publikë, të zgjedhurit dhe të emëruarit | Kryetari i Komunës dhe Kuvendi, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqës it e sektorëve | Në vazhd imësi | Njësia për Burime Njerëzore ka njoftuar të gjithë zyrtarët komunalë për obligimin e zbatimit të Kodit të Etikës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | E realizua r | | | |
| 15. | | Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës | Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunalë dhe organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e kodit. | Kryetari i Komunës dhe Kuvendi, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqës | Në vazhd imësi | Kopja e Kodit të Etikës u është shpërndarë me kohë të gjithë zyrtarëve komunalë, me qëllim të informimit dhe zbatimit të dispozitave të tij. | E realizua r | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | it e sektorëve | | | | | | |
| 16. | | Mungesa e informimit dhe mosraportimit të dhuratave nga qytetarët te punëtorët e Komunës (neni 17 dhe 18 i Rregullore (QRK - Nr. 04/2015 Për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës) | Njësia për Burime Njerëzore krijon një regjistër për regjistrimin e dhuratave të pranuara nga nëpunësit; | Njësia e Burimeve Njerëzore, të gjithë nëpunësit publikë | Në vazhd imësi | Me vendim të Kryetarit të Komunës është caktuar zyrtari përgjegjës për këtë fushë, i cili njëkohësisht është përgjegjës edhe për çështjet që lidhen me deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publikë dhe administrimin e regjistrit të dhuratave. | E realizua r | | | |
| 17. | | | Të informohet stafit për rregullat e pranimit të dhuratave. | Njësia e Burimeve Njerëzore, të gjithë nëpunësit publikë | Në vazhd imësi | Informimi i stafit lidhur me rregullat për pranimin dhe deklarimin e dhuratave realizohet nga zyrtari përgjegjës, i emëruar me vendim të Kryetarit të Komunës, i cili ushtron edhe detyrat që lidhen me deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. | E realizua r | | | |
| 18. | | Niveli i pamjaftueshëm i | Të sigurohet mbajtja e takimeve të | Kryetari i Komunës, Kuvendi, | Në vazhd imësi | Njësia për Burime Njerëzore do të bashkëpunojë me zyrtarin përgjegjës dhe me | E realizua r | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndërgjegjësimit të punonjësve për raportimin e korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme brenda institucionit. | rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme. | drejtuesit e drejtorive dhe Njësia e personelit | | stafin komunal për organizimin e takimeve informuese dhe ndërgjegjësuese lidhur me mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të kundërligjshme. | | | | |
| 19. | | | Të gjithë nëpunësit publikë të punësuar dhe ata të cilët do të rekrutohen, të nënshkruajnë deklaratën e integritetit në bazë të secilës nëpunësi do të marrë | Njësia e Burimeve Njerëzore, të gjithë nëpunësit publikë | Në vazhdimësi | Të gjithë nëpunësve publikë u është dërguar me kohë Deklarata e Integritetit për nënshkrim. Po ashtu, çdo nëpunës i ri që rekrutohet do ta nënshkruajë këtë deklaratë në përputhje me kërkesat ligjore. | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | përgjegjësinë përkatëse | | | | | | | |
| 20. | | Trajtimi joadekuat i raporteve të paraqitura nga sinjalizuesi dhe mosmbrojtja e identitetit dhe të drejtave të sinjalizuesve. | Miratimi i një akti të brendshëm për regjistrimin e raportimeve të korrupsionit brenda institucionit dhe trajtimin e tyre, si dhe mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesve. | Kryetari i Komunës, Kuvendi, drejtuesit e drejtorive, zyrtari përgjegjës | Në vazhdimësi | Është caktuar zyrtari për mbrojtjen e sinjalizuesve | E realizuar | Vendim.pdf | | |
| 21. | | Mosdeklarimi i konfliktit të interesit | Marrja e informacioneve nga drejtorët përkatës për secilin anëtar të komisionit me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtoria përkatëse | Në vazhdimësi | Njësia për Burime Njerëzore u ka dërguar njoftime përmes postës elektronike të gjithë drejtorëve të drejtorive komunale dhe zyrtarëve përkatës, duke i rikujtuar për obligimin e deklarimit dhe shmangies së çdo rasti të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare, veçanërisht gjatë emërimit të anëtarëve të komisioneve. | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **22.** | **PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE** | Planifikimi joadekuat i buxhetit vjetor komunal. | Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit | Kryetari i Komunës dhe drejtuesit e drejtorive | Në vazhdimësi | Komuna siguron pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesit gjatë procesit të planifikimit buxhetor përmes organizimit të dëgjimeve buxhetore publike në të gjitha vendbanimet, si dhe konsultimeve me organizatat e shoqërisë civile, komunitetin e biznesit, sindikatat dhe grupet e tjera të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | E realizuar | | | Të vazhdohet me informimin e vazhdueshëm rreth dëgjimeve buxhetore. |
| **23.** | | | Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi | Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, organizohen trajnime dhe punëtori profesionale për ngritjen e kapaciteteve të personelit të përfshirë në menaxhimin financiar dhe planifikimin buxhetor. Punonjësit përzgjidhen me vendim të Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF) dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA). | E realizuar | | | |
| **24.** | | Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent | Hartimi dhe miratimi i raporteve dhe planit të shpenzimeve | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet | 1 muaj | Drejtoria për Buxhet dhe Financa harton planin e shpenzimeve dhe raportet përkatëse në përputhje me buxhetin e miratuar, duke | E realizuar | https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/ | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe Financa | | siguruar që procesi i planifikimit dhe zbatimit të zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe në pajtim me dispozitat ligjore. | | 01/Plani-i-veprimeve-ne-DBF-deri-ne-perfundim-te-vitit-2026.pdf | | |
| 25. | | | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore. | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Në vazhdimësi | Raportimi mbi shpenzimet buxhetore realizohet në mënyrë periodike nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse. | E realizuar | https://rahovec.rks-gov.net/financat/?tax=raportet-mujore-financat | | |
| 26. | | | Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb faqen e komunës | Njësia për Informim | Në vazhdimësi | Plani i shpenzimeve dhe raportet financiare publikohen rregullisht në ueb-faqen zyrtare të Komunës, me qëllim të garantimit të transparencës dhe informimit të publikut. | E realizuar | https://rahovec.rks-gov.net/financat/?tax=buxheti | | |
| 27. | | | Të sigurohet mbikëqyrja e jashtme mbi zbatimin e buxhetit duke krijuar një komision të përbërë nga përfaqësuesit e komunës | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 3 muaj | Mbikëqyrja e zbatimit të buxhetit realizohet përmes mekanizmave të paraparë me legjislacionin në fuqi. Drejtoria për Buxhet dhe Financa, përkatësisht Zyrtari Kryesor Financiar, prezanton raporte financiare periodike para organeve kompetente, | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | dhe nga vëzhgues të OJQ-ve për të monitoruar zbatimin e buxhetit. | | | duke mundësuar monitorim dhe transparencë në menaxhimin e financave publike. | | | | |
| 28. | | | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 3 muaj | Drejtoria për Buxhet dhe Financa përpilon dhe raporton, raporte financiare në baza mujore. | E realizuar | https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/01/Plani-i-veprimeve-ne-DBF-deri-ne-perfundim-te-vitit-2026.pdf | | |
| 29. | | Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i aseteve komunale | Të përditësohet regjistri i brendshëm i aseteve të komunës | Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm | 6 muaj | Përditësimi i aseteve kryhet në mënyrë të vazhdueshme në sistemin SIMFK, duke siguruar regjistrimin e saktë dhe menaxhimin efikas të pasurisë së komunës. | E realizuar | | | Të vazhdohet me përditësimin e regjistrave të aseteve komunale. |
| 30. | **RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE** | Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative, si | Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rrezikun nga | Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës dhe | Në vazhdimësi | Të gjithë zyrtarët shtetërorë, përfshirë këtu edhe zyrtarët e komunës sonë njoftohen nga AShI-ja (departamenti i sigurisë) për sulme dhe mashtrime të mundshme. | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **DOKUMENTACIONIT** | dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare | mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara | sektori i IT | | | | | | |
| 31. | | Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit | Zyrtari i IT në bashkëpunim me kryetarin dhe drejtorët të bëjnë planin e organizimit të sesioneve informuese lidhur me trajnimin e stafit të administratës komunal, me ruajtjen dhe mënyrën e trajtimit të dokumentacioneve - | Drejtoria e Administratës dhe sektori i IT | Në vazhdimësi | Në shumicën e rasteve IKAP organizon trajnime për zyrtarë shtetërorë dhe nëpërmjet Zyrës së Personelit dërgojnë njoftime dhe ftesa për trajnime, e ne si komunë mund të organizojmë trajnime edhe pse shume herë i kemi njoftuar se si duhet t'i ruajnë dokumentet, si dhe iu kemi krijuar hapësirat ne file server për ruajtje. | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së brendshme mbi trajtimin e dokumentacionit dhe informacionit zyrtar | | | | | | | | |
| 32. | | Keqpërdorimi i veturave zyrtare | Të bëhet kërkesë dy ditë para përdorimit të veturës si dhe të raportohet mbi mënyrën dhe vendin ku ajo shfrytëzohet | Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi bëhet kërkesë paraprakisht për shfrytëzimin e veturave zyrtare si dhe shënohen të dhënat për vendin si dhe kilometrazhin e veturës dhe të dhënat e shfrytëzuesit | E realizuar | | | | |
| 33. | **AUDITIMI I BRENDSHËM** | Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti | Të sigurohet planifikim efektiv i auditimit i bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe të monitorohet zbatimi i | Kryetari i Komunës, Komisioni i auditimit, Njësia e Auditimit | Në vazhdimësi | Njësia e Auditimit të Brendshëm, çdo herë, planifikimin e bazon në bazë të rrezikut dhe i përmbahet atij planifikimi. (Dëshmi: Plani Vjetor i Punës). | E realizuar | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | këtij plani si dhe të planifikohen masa përmirësuese në rast nevoje. | | | | | | | | |
| 34. | | | Të sigurohen auditime rast pas rasti për të vërtetuar të gjeturat gjatë inspektimeve | | Në vazhd imësi | Njësia e Auditimit të Brendshëm, auditimet i bën rast pas rasti, siç janë të planifikuara me Planin Vjetor të Auditimit. (Dëshmi: Plani Vjetor i Punës). | E realizua r | | | | |
| 35. | | Mungesa e mbikëqyrjes adekuate, profesionale mbi zbatimin e rekomandimev e | Zhvillimi i një plani për zbatimin e rekomandim eve të auditimit | Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive | Në vazhd imësi | Njësia e Auditimit të Brendshëm, ka planin për zbatimin e rekomandimeve. (dëshmi plani për implementimin e rekomandimeve). | E eealizu ar | | | | |
| 36. | | | Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandim eve të auditimit | Drejtorët e drejtorive | Në vazhd imësi | Njësia e Auditimit të Brendshëm, raporton rregullisht për zbatimin e rekomandimeve. (dëshmi plani për implementimin e rekomandimeve). | E realizua r | | | | |
| 37, | | Mungesa e koordinimit ndërmjet Njësisë së AB, Komitetit të | Shtimi i stafit të njësisë së auditimit | Kryetari i Komunës, Njësia e AB, | Në vazhd imësi | Njësia e Auditimit të Brendshëm operon vetëm me udhëheqësin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe duhet të shtohet stafi, si dhe të | E realizua r | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Auditimit dhe Kryetarit, mungesa e mjaftushme e auditorëve | | Komiteti i Auditimit | | kompletohet njësia edhe me 2 auditorë të tjerë. | | | | |
| 38. | | Mungesa e koordinimit ndërmjet Njësisë së AB, Komitetit të Auditimit dhe Kryetarit, mungesa e auditorëve | Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale. | Kryetari i Komunës, Njësia e AB, Komiteti i Auditimit | Në vazhd imësi | Njësia e Auditimit të Brendshëm, Komiteti i Auditimit dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm kanë komunikim të mirë dhe komunikimet me organet e tjera komunale janë të përmirësuara. Kjo çështje ka mbetur në Planin e Integritetit prej shumë vitesh. | E realizua r | | | |
| 39. | **PROKU RIMI PUBLIK** | Përgatitje joefikase e specifikimeve të tenderit | Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimev e të tenderit duke marrë parasysh kriteret për mosdiskrimi nim dhe duke siguruar qasje të barabartë | Njësia e prokurimit dhe drejtorët e drejtorive përkatëse | Në vazhd imësi | Përmirësimi i dukshëm i specifikave teknike dhe jo favorizimi i specifikave, duke pasur qasje të barabartë. | E realizua r | | | |
| 40. | | | Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive | Njësia e prokurimit dhe Njësia e | Në vazhd imësi | Janë mbajtur trajnimet për personelin e prokurimit për vlerësimin e ofertave dhe | E realizua r | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | përkatëse për personelin për prokurimin publik | Burimeve Njerëzorë | | tenderat ekonomikisht me te favorshëm ndërsa për komisionin e vlerësimit kërkohet ende organizimet dhe trajnimet | | | | |
| 41. | | Mostransparenca dhe mbikëqyrja e pamjaftueshme e prokurimit publik | Publikimi i Planit të Prokurimit në faqen ueb të komunës | Njësia e prokurimit | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi publikohet plani, sipas datave të Ligjit të Prokurimit. | E realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=30116 | | |
| 42. | | | Të caktohen auditime pas prokurimit dhe dhënies së kontratës për tenderë për të rishikuar respektimin e standardeve të specifikuara procedurale | Kryetari i Komunës, Njësia e Auditimit të Brendshëm. | Në vazhdimësi | Njësia e Auditimit të Brendshëm, çdo vit bën auditim të procedurave të prokurimit. (dëshmi plani vjetor i punës – raporti i auditimit). | E realizuar | | | |
| 43. | | | Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit duke krijuar protokoll të qartë për komunikimin | Kryetari i Komunës dhe Njësia e prokurimit | Në vazhdimësi | Janë të caktuara pika të qarta të kontaktit, nëpërmjet sistemit të Prokurimit Elektronik, komunikimi behet nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik e-prokurimit. | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | me ofertuesit dhe duke krijuar pika të qarta të kontaktit | | | | | | | |
| 44. | | Menaxhimi joefikas i kontratave/projekteve | Trajnimi i personelit për menaxhimin e kontratave/projektit | Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorë të drejtorive përkatëse | Në vazhdimësi | Janë mbajtur trajnime për menaxherët e kontratave, por kërkohet të bëhen më shpesh këto trajnime | E realizuar | | | |
| 45. | **ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL** | Hartimi strategjisë së re për zhvillim ekonomik, mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik lokal | Hartimi, rishikimi, përditësimi si dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 12 muaj | Komuna është në proces të hartimit të Strategjisë për Zhvillim Komunal për periudhën 2026–2030. Deri më tani, zhvillimi i politikave strategjike është bazuar në Strategjinë për Zhvillim Komunal 2021–2025. | E Parealizuar | | | |
| 46. | | Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të | Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 12 muaj | Prioritetet e zhvillimit ekonomik përcaktohen vazhdimisht duke u bazuar në nevojat e qytetarëve, kërkesat e grupeve të interesit, debatet | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | paqarta dhe jotransparente. | | | | publike dhe format e tjera të konsultimit me publikun. | | | | |
| 47. | | | Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit komunal. | | 12 muaj | Kjo masë zbatohet në mënyrë periodike. Gjatë hartimit dhe përcaktimit të prioriteteve të zhvillimit ekonomik lokal sigurohet pjesëmarrja e palëve të interesit, si dhe bëhet vlerësimi i nevojave dhe prioriteteve për investime. | E realizuar | | | |
| 48. | | Kritere jo të qarta dhe transparencë e pa mjaftueshme në ndarjen e subvencioneve | Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika korruptive | Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive përkatëse | Në vazhdimësi | Ndarja e subvencioneve realizohet në përputhje me Rregulloren e Brendshme nr. 1427, datë 28.4.2017, e cila përcakton kriteret për përfitim dhe procedurat për formimin e komisionit përgjegjës për shqyrtimin dhe ndarjen e subvencioneve. | E realizuar | Rregullorja-per-nen-subvencioneve | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 49. | | | Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve | Kryetari i Komunës; Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | Në vazhdimësi | Në komisionin për ndarjen e subvencioneve, përfshihet në mënyrë të rregullt edhe të paktën një përfaqësues i shoqërisë civile, me qëllim rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së procesit. | E realizuar | | | | |
| 50. | | Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për zhvillimin ekonomik lokal | Të sigurohet personel adekuat profesional për zhvillimin ekonomik lokal | Kryetari i Komunës; Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi | Në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi funksionon Sektori i Zhvillimit Ekonomik, ku është i angazhuar staf profesional që bashkëpunon me zyrtarët e tjerë të komunës dhe ndjek vazhdimisht trajnime, punëtori dhe aktivitete profesionale në fushën e zhvillimit ekonomik. | E realizuar | | | | |
| 51. | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e zhvillimin ekonomik lokal | | Në vazhdimësi | Drejtoria për Ekonomi ka zyrtarë profesionalë me përvojë, të cilët kanë ndjekur trajnime të organizuara nga organizata të ndryshme, përfshirë German Cooperation, dhe janë të certifikuar për proceset e ndarjes së subvencioneve, monitorimit të granteve dhe menaxhimit të tyre. | E realizuar | | | | |
| 52. | | Mbikëqyrja jo efikase mbi zbatimin e aktiviteteve të | Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e | Kryetari i Komunës, Drejtoria për | 3 muaj | Në kuadër të zhvillimit ekonomik të Komunës së Rahovecit, Drejtoria për Ekonomi formon komisione | E realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?page | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | zhvillimit ekonomik lokal | aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal | Zhvillim Ekonomik | | të veçanta për monitorimin e projekteve zhvillimore. Për secilin projekt hartohen raporte të detajuara me shkrim, të cilat dokumentojnë ecurinë e zbatimit dhe rezultatet e arritura. | | _id=20000 1049 | | |
| 53. | | Hartimi i strategjisë së turizmit lokal | Mbikëqyrja e strategjisë së turizmit | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | Në vazhdimësi | Mbikëqyrja e zbatimit të Strategjisë së Turizmit realizohet nga zyrtarja përgjegjëse për turizëm në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm. Ajo përcjell zbatimin e aktiviteteve të planifikuara dhe raporton për progresin e arritur. | | | | |
| 54. | **PLANIFIKIMI URBAN DHE RURAL** | Mangësi në rregullativën e brendshme që lidhet me fushën e planifikimit urban dhe rural | Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | 12 muaj | Është miratuar PZHK (Plani Zhvillimor i Komunës), ndërsa HZK (Harta Zonale e Komunës) është në proces të miratimit. Harta Zonale do të rregullojë procesin e dhënies së lejeve ndërtimore. Harta Zonale ka marrë pëlqim nga Ministria për hapjen e shqyrtimit publik. Me miratimin e këtij dokumenti do të krijohen mundësi më të mira dhe më transparente në pjesën e ndërtimit. | Pjesërisht e realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?newscpt=miratohet-plani-zhvillimor-komunal-per-tete-vitet-e-ardhshme-2023-2031 | | Të hartohet dhe miratohet Harta Zonale, në mënyrë që të rregullohet procesi i dhënies së lejeve ndërtimore. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | parandalojnë vendimet subjektive | | | | | | | |
| 55. | | Zbatim jo i plotë i rregullativës së brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural | Të rritet mbikëqyrja e zbatimit të rregullativës së brendshme | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | 12 muaj | Me vendim të Kryetarit të datës 15.09.2022, janë emëruar zyrtarë përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje për rrënim.<br><br>Mbikëqyrja realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga drejtoria përmes kontrollit të procedurave, shqyrtimit të lëndëve dhe monitorimit. | E realizuar | | | |
| 56. | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural | | Në vazhdimësi | Për të gjithë zyrtarët sigurohet trajnim i nevojshëm. Është realizuar përmes pjesëmarrjes së stafit në programe të ndryshme trajnuese dhe zhvillimit profesional të vazhdueshëm | E realizuar | | | |
| 57. | | Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve | Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim | | Në vazhdimësi | Është siguruar personel adekuat dhe profesional për planifikimin urban dhe rural. Drejtoria vazhdon të funksionojë me stafin ekzistues profesional, ndërsa mbetet nevoja për plotësimin | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për planifikim urban dhe rural | urban dhe rural | | | e kapaciteteve me profile shtesë, sipas nevojave të drejtorisë. Të parapara për vitin 2026 janë edhe dy pozita për rritjen e stafit me profesionistë të fushës. | | | | | |
| 58. | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural | | Në vazhdimësi | Është bërë trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural. | E realizuar | | | | Të vazhdohet me trajnimin e stafit edhe në të ardhmen. |
| 59. | | Mbikëqyrja jo efikase mbi zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural | Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Në vazhdimësi | Bëhet kontroll dhe raportim i rregullt për mënyrën e zbatimit të aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural. | E realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?page_id=200000036 | | | |
| 60. | **STANDARDET E NDËRTIMIT DHE KONTROLLI** | Mungesa e kontrolleve konsistente mbi ndërtimet (vendpunishtet) | Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje. | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Në vazhdimësi | Në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektoratit janë duke u bërë kontrolle në terren. | E realizuar | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 61. | | Mungesë e stafit adekuat për kontrollimin e ndërtimeve | Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | 9 muaj | Me vendim të Kryetarit, të datës 15.09.2022, janë emëruar zyrtarët përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje për rrënim. | E realizuar | | | |
| 62. | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi | Në bashkëpunim me Njësinë për Burime Njerëzore, organizohen trajnime të ndryshme. Edhe këtë vit janë organizuar trajnime për stafin. | E realizuar | | | |
| 63. | **INSPEKTIMET** | Mungesa e planifikimit të duhur të inspektimeve | Të sigurohet plani vjetor i inspektimeve për çdo fushë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut. | Drejtoria e Inspektimeve | Në vazhdimësi | Drejtoria për Punë Inspektuese thekson se harton Planin Vjetor të Punës së Inspektimeve për tërë vitin kalendarik. Ky plan përgatitet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazohet në vlerësimin e rrezikut, duke marrë në konsideratë natyrën e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë, rezultatet e inspektimeve të mëparshme, ankesat e pranuara dhe faktorë të tjerë relevantë. Në këtë mënyrë, inspektimet | E realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=317 | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | planifikohen sipas prioriteteve dhe nivelit të rrezikut, me qëllim të rritjes së efektivitetit të mbikëqyrjes inspektuese. Prioritet do t'u jepet fushave dhe operatorëve me nivel më të lartë të rrezikut. | | | | |
| **64.** | | Mungesa e kapaciteteve profesionale të inspektorëve | Organizimi i trajnimeve profesionale për inspektoret | Drejtoria e inspektimeve, Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi | Drejtoria konsideron se ngritja e kapaciteteve profesionale të inspektorëve është një proces i vazhdueshëm. Në bashkëpunim me institucionet kompetente dhe partnerët përkatës, planifikohen dhe realizohen trajnime profesionale, në varësi të mundësive buxhetore dhe programeve të disponueshme. | E realizuar | | | |
| **65.** | | Numër i pamjaftueshëm i inspektorëve | Të sigurohet numër i mjaftueshëm i inspektorëve nga personeli i brendshëm i komunës ose punësime të reja | | 6 muaj | Drejtoria vlerëson se rritja e numrit të inspektorëve do të ndikonte pozitivisht në përmbushjen e kompetencave ligjore. Nevojat për staf do t'i adresohen menaxhmentit komunal përmes kërkesave të arsyetuara, ndërsa plotësimi i pozitave do të realizohet në përputhje me buxhetin e | Pjeserisht e realizuar | | | Të rritet numri i inspektorëve dhe i inspektimeve në të ardhmen. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | miratuar dhe procedurat ligjore të rekrutimit. | | | | |
| 66. | | Mungesa e kontrolleve mbi operatorët ekonomikë | Fuqizimi i sistemit të kontrolleve mbi funksionimin e operatorëve të biznesit. Të rriten gjobat për operatorët pa regjistrim dhe licenca valide të biznesit | Drejtoria e inspektimeve | Në vazhdimësi | Drejtoria do të vazhdojë fuqizimin e kontrolleve ndaj operatorëve ekonomikë në kuadër të kompetencave të saj ligjore. Sa i përket propozimit për rritjen e gjobave ndaj operatorëve pa regjistrim ose pa licenca valide, kjo çështje rregullohet me ligjet në fuqi dhe nuk është në kompetencë të Drejtorisë apo të Komunës që të ndryshojë lartësinë e sanksioneve. Drejtoria do të zbatojë masat ndëshkuese sipas legjislacionit në fuqi dhe do t'u propozojë institucioneve kompetente ndryshimet e nevojshme, nëse vlerësohet e arsyeshme. | E realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?page_id=200001049 | | |
| 67. | | Mungesa e transparencës për punën e njësisë së inspektimit | Ka nevojë që në D.I të publikojë në baza vjetore listën e bizneseve të inspektuara dhe | Drejtoria e inspektimeve Njësia për Informim | Në vazhdimësi | Drejtoria e vlerëson rekomandimin si një masë që kontribuon në transparencën institucionale. Në përputhje me legjislacionin për qasje në dokumente publike, mbrojtjen e të dhënave personale dhe dispozitat e tjera ligjore në | E realizuar | https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=317 | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | shpeshtësinë e inspektimeve | | | fuqi, do të shqyrtohet mundësia e publikimit të raporteve vjetore me të dhëna të përgjithshme mbi aktivitetet inspektuese, përfshirë numrin e bizneseve të inspektuara dhe shpeshtësinë e inspektimeve, duke respektuar kufizimet ligjore për publikimin e të dhënave. | | | | |
| **68.** | **ARSIMI PUBLIK** | Monitorimet e pamjaftushme të procesit arsimor.<br><br>Inspektimet e pamjaftueshme të procesit mësimor | Të hartohet plani i monitorimit dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij | Drejtoria e Arsimit | Në vazhdimësi | Drejtoria e Arsimit për çdo vit shkollor harton plan të monitorimit të vazhdueshëm të institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Rahovecit | E realizuar | | | |
| **69.** | | Rekrutimi i stafit në sektorin e edukimit nuk është efikas | Rekrutimi i stafit të duhur arsimor, kujdesi i veçantë në marrjen e stafit për zonat ku ka nevojë; urgjente. | | Në vazhdimësi | Drejtoria e Arsimit është e përkushtuar në zbatimin e përpiktë të stafit, bazuar në Rregulloren QRK 19/2024, duke përfillur në plotni çdo rekomandim të dalë nga kjo rregullore. Dëshmi për këtë është procesi i intervistimit të kandidatëve për drejtorë të shkollave, ku në panele janë | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Rishikimi i procedurave operacionale për rekrutimin e stafit në sektorin e edukimit për të siguruar kontrolle adekuate të integritetit, p.sh. përfshirja e OJQ-ve, aktorëve të tjerë të jashtëm në panelet intervistuese, dhe rritja e transparencës së procesit të intervistimit, rritja e publicitetit të rezultateve të përzgjedhjes. | | | të përfshirë KDSH-të dhe përfaqësues të sindikatës së arsimit. Sa i përket deficitit profesional, nuk është në kompetencë të DKA-së përgatitja e kuadrove, kështu që DKA detyrohet shumë herë të rekrutojë mësimdhënës të profileve të përafërta aty ku ka deficit profesional.<br><br>Sa i përket transparencës dhe publicitetit të rezultateve, si DKA jemi në harmoni të plotë me transparencën dhe publikimin e rezultateve të rekrutimit përmes ueb-faqes së Komunës së Rahovecit.<br><br>DKA, për çdo vit, dërgon në Zyrën e Personelit. | | | | | |
| 70. | | Mungesa e stafit pedagogjik | Shtimi i stafit pedagogjik | Drejtoria e Arsimit | Në vazhd imësi | Planifikimet për staf pedagogjik. Megjithatë, ne | E parealiz uar | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | ende kemi mungesë të stafit pedagogjik në DKA. | | | | |
| 71. | | Siguria e dobët fizike e shkollave | Përmirësimi i sigurisë fizike të shkollave me rekrutimin e stafit profesional të sigurisë | | Në vazhdimësi | Të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës së Rahovecit kanë rrethoja statike të hapësirave shkollore, si dhe vëzhgim të sistemit të kamerave, kurse sa i përket stafit fizik të sigurisë, momentalisht nuk kemi staf të tillë, për shkak të kufizimeve në numër të personelit. | Pjesërisht e realizuar | | | Të vazhdohet me vendosjen e kamerave nëpër të gjitha objektet shkollore, në mënyrë që të rritet siguria në shkolla. |
| 72. | **SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE** | Trajnimi i punonjësve, edukimi mbi etikën mjekësore. | Stafi shëndetësor duhet të jetë i trajnuar për të kuptuar rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale dhe si të menaxhojnë informacionet mjekësore në mënyrë të sigurt. Ky trajnim duhet të mbulojë politikat për mbrojtjen e | Drejtoria për Shëndetësi | Në vazhdimësi | Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ndërmerr masa për forcimin e kapaciteteve të stafit shëndetësor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Po ashtu, organizohen trajnime periodike për stafin, të cilat do të mbulojnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, praktikat e sigurta për menaxhimin e informacioneve mjekësore, si dhe procedurat për identifikimin, raportimin dhe trajtimin e rasteve të shkeljeve të mundshme të sigurisë së të dhënave. Përmes këtyre | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | privatësisë dhe mënyrat për të reaguar në rast të shkeljeve të mundshme të integritetit | | | aktiviteteve synohet të rritet niveli i ndërgjegjësimit dhe të sigurohet respektimi i standardeve ligjore dhe profesionale në mbrojtjen e privatësisë së pacientëve. | | | | |
| 73. | | Mangësi në rregullativën e brendshme lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe zbatimi jo i plotë i saj | Të rishikohet rregullativa e brendshme me qëllim të përmirësimit dhe plotësimit. | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe drejtuesit e institucioneve shëndetësore | 12 muaj | Përveç aspektit ligjor, është thelbësore që të gjithë punonjësit e shëndetësisë të kuptojnë dhe të respektojnë standardet etike të profesionit, të cilat janë gjithashtu një formë mbrojtjeje për integritetin e informacionit. | E realizuar | | | |
| 74. | | Mungesa e transparencës në punën e Qendrës për Punë Sociale | Rritja e transparencës në punën e Qendrës për Punë Sociale, përmes mundësimit të qasjes në informata në faqen ueb të | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | Në vazhdimësi | Në Qendrën për Punë Sociale bëhet publikimi i rregullt i informatave të plota, të sakta dhe të përditësuara në ueb-faqen zyrtare, lidhur me aktivitetet e realizuara, shërbimet e ofruara, njoftimet dhe informatat e tjera me interes publik. | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | saj lidhur me aktivitetet e kryera me informata të plota | | | | | | | | |
| 75. | **SHËRBIMET PUBLIKE DHE LICENCIMI I TYRE** | Efikasitetit, efektivitetit, cilësia e transparencës jo e kënaqshme në ofrimin e shërbimeve publike | Të zvogëlohet mundësia e kontakteve mes palëve të interesuara dhe zyrtarit që merr vendim (vendimi të merret nga zyrtari profesional, ndërsa pagesa dhe dërgimi i vendimit të bëhet në zyrat pritëse nga zyrtari tjetër | Mbikëqyrësi i shërbimeve publike | Në vazhdimësi | Të gjitha vendimet bëhen në zyre të komunës, mbikëqyrja bëhet në terren. Vendimet merren nga zyrtari profesional, ndërsa pagesat dhe dërgimi i vendimeve bëhet nga zyrtari tjetër | E realizuar | | | | |
| 76. | | Mungesa e kontrollit në implementimin e projekteve të mirëmbajtjes | Shtimi i kontrolleve, rritja e kapaciteteve të kompanive kontraktuse | Mbikëqyrësi i shërbimeve publike | 12 muaj | Vazhdimisht ka mbikëqyrje, kontroll dhe monitorim të kontratave, kemi edhe raportime në kuvend sipas planit te hartuar për vitin 2026. | E realizuar | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 77. | | Rreziku nga hedhja e pakontrolluar e mbeturinave, menaxhimi i pamjaftueshëm i rrezikut në menaxhimin e mbeturinave | Sensibilizimi i qytetarëve rreth vendeve për hedhjen e mbeturinave, sigurimi i kontrolleve strikte. Përmirësimi i kornizës strategjike me hartimin dhe miratimin e një rregulloreje komunale të menaxhimit të mbeturinave, sigurimi i kontrolleve strikte dhe dhe i llogaridhënies së operatorëve | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria përkatëse për shërbime publike dhe licencimin e tyre | 12 muaj | Është në fazën e përgatitjes strategjia re për menaxhimin e integruar të mbeturinave, së bashku me GIZ-un gjerman, ka llogaridhënie strikte çdo muaj, po ashtu edhe raportim që kërkohet nga ministria | E parealizuar | | | |
| 78. | | | Të rritet profesionalizmi i stafit përmes trajnimeve, shkëmbimit | Drejtoria përkatëse për Shërbime Publike dhe Njësia | Në vazhdimësi | Mbahen herë pas here trajnime, në bashkëpunim me organizata të huaja, qoftë përmes asociacionit. Shkëmbejmë përvoja me komunat e tjera | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | të përvojave, punëtorive | e Burimeve Njerëzore | | | | | | |
| 79. | | Probleme pronësore për implementimin e projekteve | Shpronësimi – kompensimi, dhënia në mirëbesim e pronës autoritetit komunal | Drejtoria për Shërbime Publike dhe Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtoria përkatëse për Shërbime Publike | Në vazhdimësi | Të gjitha këto jepen sipas ligjit, edhe pse në shume raste komuna nuk shpronëson apo kompenson pronat komunale, mirëpo me pronat private duhet të bëhet kujdes, aty ku merret duhet të kompensohet paraprakisht | E realizuar | | | . |
| 80. | | Mangësi në rregullativën e brendshme lidhur me licencimin e shërbimeve | Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e licencimit të | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria përkatëse për licencimin e shërbimeve | 12 muaj | Të gjitha vendimet bazohen në ligj, ka transparencë, kemi llogaridhënie dhe nuk ka asnjë vendim që merret duke shkelur rregulloret dhe dispozitat | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | cilat parandalojnë vendime subjektive | | | | | | | |
| 81. | | Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për licencimin e shërbimeve | Të sigurohet trajnimi i stafit për licencimin e shërbimeve | Drejtoria përkatëse për licencimin e shërbimeve dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi | Mbahen trajnime sipas nevojës. Herë pas here, mbahen aktivitete të tilla që i hyjnë në punë stafit. Marrin pjesë në çdo trajnim. | E realizuar | | | |
| 82. | **KOMUNIKIMI ME PALË TË JASHTME TË INTERESIT** | Mungesa e transparencës dhe konsultimeve me palë të jashtme të interesit gjatë hartimit të rregulloreve dhe buxheteve komunale | Të rritet transparenca dhe të merren masa për konsultime me palë të jashtme të interesit gjatë zhvillimit të rregulloreve komunale dhe të buxhetit (postimi i projekt-rregulloreve në ueb faqe, inicimi i | Kryetari i Komunës, Drejtoria përkatëse dhe Njësia e Informimit | Në vazhdimësi | Në të gjitha proceset e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike për këtë vit u bë njoftimi me kohë, ashtu siç parashihet në Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike, 14 ditë para, në ueb-faqen zyrtare, në rrjetet sociale, si dhe në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë. Gjithashtu, vendoset njoftimi i afishuar në hyrje të objektit komunal. Të gjitha dokumentet që futen në konsultime publike publikohen në ueb-faqen zyrtare të komunës, duke qenë | E realizuar | https://rahovec.rks-gov.net/rregulloret/ https://rahovec.rks-gov.net/konsultime-publike/ | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | diskutimeve publike, grupe fokusi etj.) | | | të qasshme për publikun. Konsultohen palët e interesit, si dhe kryhen procedurat në tërësi, ashtu siç parashihen, duke publikuar procesverbale dhe raporte nga proceset e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike. Në konsultimet publike mund t'i gjeni strategjitë dhe planet të cilat kanë qenë në konsultim publik, së bashku me procesverbalet dhe raportet e mbajtjes së konsultimeve publike. | | | | | |
| 83. | | Mungesa e partneritetit me shoqërinë civile në fushën e antikorrupsionit dhe bashkëpunimit me komunitetin e bizneseve | Të zhvillohen partneritete me shoqërinë civile në fushën e antikorrupsionit duke themeluar grupe pune teknike për menaxhimin e riskut në fushat e ndjeshme dhe të brishta ndaj | Kryetari i Komunës, Drejtoria përkatëse dhe Njësia e Informimit | Në vazhdimësi | Në të gjitha grupet punuese dhe vendimet që merr kryetari i Komunës, një anëtar i përket shoqërisë civile duke i përfshirë direkt në proceset vendimmarrëse. | E realizuar | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | korrupsionit dhe të sigurohet përfshirja e OJQ-ve. | | | | | | | |
| 84. | | | Të forcohen mekanizmat e konsultimeve me bizneset përmes takimeve periodike konsultative | | Në vazhdimësi | Në të gjitha proceset e takimeve publike, dëgjimeve buxhetore, bizneset janë thirrur veçanërisht duke i konsultuar dhe duke marrë kërkesa nga ta. Dëshmi keni njoftimet dhe raportet | E realizuar | https://rahovec.rks-gov.net/degjime-buxhetore/?tax=njofti me https://rahovec.rks-gov.net/degjime-buxhetore/?tax=raporte-per-buxhet | | |
| 85. | | | Të rritet rrjedha e informacionit drejt medias dhe publikut lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe të aktiviteteve | | Në vazhdimësi | Për të gjitha aktivitetet janë të njoftuara mediat dhe publiku në tërësi në kohë reale. | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | të luftës kundër tij. | | | | | | | | |
| 86. | DREJTORIA PËR GJODEZI, KADASTER DHE PRONË | Mungesa e transparencës për përdorimin e dokumenteve | Rritja e përdorimit të e-shërbimit dhe monitorimi elektronik i dokumenteve, të rritet transparenca | Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë | Në vazhdimësi | Kërkesat për përdorimin e e-shërbimeve janë të vazhdueshme, është rritur nr. i përdoruesve të shërbimeve të produkteve në e- kosova, është avancuar skanimi i dokumenteve të obligueshme. Monitorimi i dokumenteve dhe skanimi bëhet në vazhdimësi nga ZKK-ja (Zyra Kadastrale e Komunës) dhe AKK-ja (Agjencia Kadastrale e Kosovës). | E realizuar | | | | |
| 87. | | Mungesa e kapaciteteve brenda njësisë kadastrale | Rritja e zhvillimit profesional të stafit sipas nevojës. | Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë Njësia e Personelit | Në vazhdimësi | Zhvillimi profesional i stafit është i vazhdueshëm dhe bëhet sipas nevojës, në bashkëpunim me AKK-në. | E realizuar | | | | |
| 88. | | | Ofrimi i trajnimeve rifreskuese/të vazhdueshme për rregullat e reja ose | | Në vazhdimësi | Trajnimet dhe rregullat e reja mbahen vazhdueshëm nga AKK-ja për ZKK-në. | E realizuar | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | kornizat për matje kadastrale. | | | | | | | |
| 89. | | | Licencimi i KP për gjeodezi e ka lehtësuar punën e matjes në terren | | Në vazhdimësi | AKK-ja, përveç licencimit të kompanive private, po organizon edhe trajnime për operatorë privatë varësisht prej kornizave ligjore. | E realizuar | | | |
| 90. | **DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT** | OJQ-të dhe organizatat sportive nuk zgjidhen rregullisht | Ndërmarrja e masave për përzgjedhjen e rregullt të OJQ-ve dhe organizatave sportive | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | Në vazhdimësi | DKRS-ja ka ndërmarrë masat e nevojshme për zhvillimin e proceseve të rregullta, transparente dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara ligjore për përzgjedhjen e organizatave joqeveritare (OJQ) dhe organizatave sportive. Përzgjedhja realizohet përmes thirrjeve publike, vlerësimit të aplikacioneve sipas kritereve të miratuara dhe respektimit të parimeve të barazisë, transparencës dhe llogaridhënies në ndarjen e mbështetjes komunale | E realizuar | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14831 | | |
| 91. | | Korniza strategjike për kulturë, rini | Përmirësimi i kornizës strategjike | | 12 muaj | DKRS-ja ka ndërmarrë veprime për përmirësimin e kornizës strategjike në fushën | E realizuar | https://kk.rks-gov.net/Ra | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe sport nuk ekziston | për Kulturë, Rini dhe Sport duke hartuar Planin e Veprimit komunal për Rini, Kulturë dhe Sport. Të gjitha aktivitetet kulturore sportive dhe rinore, të planifikohen me buxhet për çdo vit nga DKRS-ja | | | e kulturës, rinisë dhe sportit, duke hartuar dhe zbatuar Planin Komunal të Veprimit për Kulturë, Rini dhe Sport. Në kuadër të këtij plani, aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore planifikohen në baza vjetore dhe përfshihen në procesin e planifikimit buxhetor të DKRS-së, duke siguruar mbështetje financiare dhe realizim të qëndrueshëm të tyre. | | hovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/DRAFT-Plani-i-trashegimise-kulturore-2022-2024.pdf | | |
| 92. | | Mungesa e kapaciteteve profesionale e punëdhënësve sportiv | Krijimi i një programi specifik për forcimin e kapaciteteve për punëdhënësit sportiv, si dhe për personat përgjegjës për menaxhimin e zonave sportive. Të | | Në vazhdimësi | DKRS-ja ka ndërmarrë hapa për forcimin e kapaciteteve të organizatave sportive, klubeve dhe personave përgjegjës për menaxhimin e objekteve dhe hapësirave sportive, përmes mbështetjes institucionale, këshillimit profesional dhe aktiviteteve të ndryshme trajnuese. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, është promovuar edhe rëndësia e integritetit në sport, duke inkurajuar zbatimin e parimeve të transparencës, | E Realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | sigurohet se menaxhimi i integritetit të bëhet pjesë e saj. DKRS, siguron mjetet financiare nga kategoria e subvencione ve për klube sportive OJQ dhe nga aspekti infrastruktur or me objekte dhe hapësira për zhvillim të aktiviteteve | | | llogaridhënies, etikës dhe menaxhimit të mirë në organizatat sportive. Po ashtu, DKRS-ja siguron mbështetje të vazhdueshme financiare për klubet sportive dhe organizatat joqeveritare përmes ndarjes së subvencioneve në bazë të thirrjeve publike dhe kritereve të përcaktuara. Krahas mbështetjes financiare, DKRS-ja ofron edhe mbështetje infrastrukturore duke vënë në dispozicion objekte sportive, palestra, fusha sportive dhe hapësira të tjera publike për zhvillimin e aktiviteteve sportive, rekreative dhe rinore, me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e sportit në komunë. | | | | |
| 93. | | Numri i pamjaftueshëm i programeve të integritetit, etikës dhe pajtueshmërisë për të rinj | Zbatimi i programeve të integritetit, etikës dhe pajtueshmëri së dhe fushat për të rinjtë | | Në vazhd imësi | DKRS-ja mbështet dhe promovon zbatimin e programeve që lidhen me integritetin, etikën dhe pajtueshmërinë në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Përmes aktiviteteve edukative, fushatave ndërgjegjësuese, trajnimeve dhe bashkëpunimit | E realizua r | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | me institucionet përkatëse, të rinjtë informohen dhe inkurajohen të respektojnë vlerat e fair-play, përgjegjësisë, transparencës, respektit të ndërsjellë dhe pjesëmarrjes aktive në shoqëri. Këto aktivitete kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe gjithëpërfshirës për zhvillimin personal dhe shoqëror të të rinjve | | | | |
| 94. | DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL | Kritere jo të qarta dhe transparencë e pa mjaftueshme në ndarjen e subvencioneve për zhvillimin e bujqësisë dhe sektorëve tjerë | Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika korruptive | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural | Në vazhdimësi | Vazhdimisht, pra çdo vit, zbatohet rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe asnjëherë nuk ka vend për praktika korruptive. | E realizuar | | | |
| 95. | | | Pjesëmarrja e shoqërisë civile në | | Në vazhdimësi | Në secilin komision të shpërndarjes së subvencioneve | E realizuar | https://kk.rks-gov.net/rah | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve | | | përfshihet një anëtar i shoqërisë civile. | | ovec/?page_id=200003294 | | |
| 96. | | Mungesa e vetëdijes për rreziqet në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë | Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me menaxhimin e rreziqeve specifike në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë dhe rreth burimeve alternative të ngrohjes | | Në vazhdimësi | Në kuadër të DBPZHR-së funksionon faqja në rrjetin social Facebook, përmes së cilës shpërndahen mesazhe vetëdijesuese për qytetarët e komunës sonë, si në këshillimin për kultivimin e pemëve dhe perimeve, po ashtu edhe në rastet e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe temperaturat e ulëta. Po ashtu, është organizuar një takim sa i përket mbrojtjes së bimëve, ku kanë qenë të ftuar të gjithë fermerët.<br><br>Përpos kësaj, çdo vit mbahet takim me IFC-në, me qëllim të vetëdijesimit të fermerëve për sigurimin e kulturave bujqësore, si nga ngricat, ashtu edhe nga temperaturat e larta. | E realizuar | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 97. | | Kontrolli jo efikas mbi zbatimin e shërbimeve të zhvillimit të përdorimit të tokave | Rritja e kontrollit mbi zbatimin e shërbimeve të zhvillimit dhe përdorimit të tokës | | Në vazhdimësi | Në bashkëpunim me MBPZhR-në çdo vit bëhet përzgjedhja e fermerëve që sigurojnë mostra për analiza të dheut dhe kjo përmes departamentit te shërbimeve këshillimore. | E realizuar | | | |

Rahovec
14.07.2026

Koordinatori për Integritet
Valmir Gashi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KRYETARI I KOMUNES SË RAHOVECIT / PREDSEDNIK OPŠTINE ORAHOVAC / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC